

STATISTIKAT MAKROEKONOMIKE NË SHQIPËRI:
KËNDVËSHTRIMI I FMN

Armida San Jose
Departamenti i Statistikës
Fondi Monetar Ndërkombëtar

STATISTIKAT MAKROEKONOMIKE NË SHQIPËRI: KËNDVËSHTRIM I FMN

1. HYRJE

Mirëmëngjes z. Guvernator, znj. Ekonomi dhe të ftuar të tjerë të nderuar. Jam e gëzuar që marr pjesë në konferencën e parë kombëtare në Shqipëri mbi statistikat për të diskutuar çështjet përkatëse, që kanë të bëjnë me informacionin statistikor në Shqipëri. Znj. Karol Karson, Drejtore e Departamentit të Statistikave në FMN, nuk mundi të marrë pjesë në këtë simpozium për shkak të angazhimeve të saj, por ju dërgon përshëndetjet më të mira dhe urimet për një konferencë të suksesshme.

Sot do të përqendrohemi në tri probleme madhore: (1) elementet për të pasur një sistem të mirë statistikor; (2) progresin e bërë nga Shqipëria në ndërtimin e një sistemi të tillë, përfshi anët e dobëta dhe të forta të sistemit aktual; dhe (3) hapat e mëtejshëm, që duhen ndërmarrë për të ndërtuar një sistem të aftë për të luajtur një rol kryesor në zhvillimin ekonomik.

2. ELEMENTET PËR TË PASUR NJË SISTEM TË MIRË STATISTIKOR

Së pari, duhet përmendur që nuk mund të nënvlerësojmë rëndësinë e statistikave të mira. Të dy sektorët, privat dhe shtetëror, përfitojnë nga të dhënat me cilësi të lartë dhe të disponueshme në kohë pasi ata hartojnë politika dhe marrin vendime duke qenë të mirëinformuar.

Forcimi i bazës së të dhënave të statistikave kombëtare do të ndihmojë në përmirësimin e monitorimit të zhvillimeve ekonomike dhe në lehtësimin e hartimit, të zbatimit dhe të mbikëqyrjes së politikave makroekonomike.

Kjo gjë siguron një pamje më të mirë të mirëqenies ekonomike të një vendi tek investitorët e huaj potencialë dhe shërben si informacion për komunitetin ndërkombëtar në tërësi. Ky aspekt nuk mund të nënvlerësohet në botën moderne në të cilën globalizimi është normë dhe teknologjia po mundëson përdorimin dhe shkëmbimin lehtësisht të informacionit midis njerëzve në pjesë të ndryshme të botës.

Kriza financiare e viteve '90 ekspozoi dobësi të sistemit financiar ndërkombëtar, duke theksuar faktin që globalizimi sjell po aq rreziqe sa edhe përfitime. Në përgjigje të saj, komuniteti ndërkombëtar u mobilizua për të forcuar arkitekturën e sistemit financiar ndërkombëtar, e cila përbëhet nga institucionet, tregjet dhe praktikrat që qeveritë, bizneset dhe individët përdorin, kur ndërmarrin aktivitete financiare dhe ekonomike.

Një element i rëndësishëm i nismës "për arkitekturën" angazhon zhvillimin dhe zbatimin e standardeve të pranuar në shkallë ndërkombëtare ose kodeve të praktikave të mira (për shembull, nxitja e praktikave të mira të transparencës për të dhënat dhe politikrat monetare e fiskale), respektimi i të cilave ndihmon që të sigurohemi se çdo ekonomi funksionon si duhet në nivel kombëtar, gjë e cila është një kërkesë e domosdoshme për një sistem ndërkombëtar që të funksionojë mirë. Në thelb, krizat e viteve '90 nxorën në pah rëndësinë, jo vetëm të transparencës ose të shpërndarjes së të dhënave, por edhe të përpilimit të të dhënave me cilësi të lartë.

Në thelb, elementet e një sistemi të mirë statistikor mund të grupohen në tre përbërës kryesorë: së pari, prania e institucioneve të mirëkrijuara, që punojnë së bashku, që kanë burime të mjaftueshme dhe që i përgjigjen ndryshimeve të kërkesave për të dhëna, të cilat mund të ofrojnë rolin e udhëheqësit në hartimin dhe shpërndarjen e të dhënave me cilësi të lartë dhe në kohë; së dyti, përpilimi i të dhënave duke përdorur metodologjitë standarde ndërkombëtare; dhe, së treti, shpërndarja e të dhënave në mënyrë efikase nëpërmjet medias së duhur. Për të mbajtur një sistem të tillë, është e nevojshme të kesh një kuadër të fortë ligjor.

Misione të vazhdueshme të Departamentit të Statistikave të FMN (STA) shërbejnë për të siguruar produkte dhe shërbime statistikore me cilësi të lartë, të cilat lehtësojnë analizimin dhe formulimin e politikës makroekonomike nga pozita të të qenit i mirëinformuar në FMN, në vendet anëtare dhe në komunitetin ndërkombëtar. Me qëllim që të përmbushen objektivat në lidhje me vendet anëtare dhe komunitetin ndërkombëtar në tërësi, STA synojnë:

- zhvillimin dhe nxitjen e përdorimit të standardeve ndërkombëtare për përpilimin e statistikave makroekonomike, të cilat i përgjigjen kërkesave në ndryshim për analiza ekonomike dhe financiare dhe informimit për politikën në vendet anëtare;
- rritjen e kapaciteteve institucionale të vendeve anëtare për të: (i) analizuar zhvillimet ekonomike dhe financiare, (ii) hartuar, zbatuar dhe mbikëqyrur politikën ekonomike dhe financiare; (iii) zhvilluar kuadrin e politikës makroekonomike bazuar në bazën e të dhënave kombëtare, e cila është e saktë, e disponueshme në kohë, ka vijimësi dhe është në përputhje me standardet e pranuar në shkallë ndërkombëtare; dhe (iv) trajtuar aspektet kritike të politikës statistikore (për shembull, legjislacionin në fushën e statistikave, bashkëpunimin midis institucioneve në përpilimin e statistikave dhe shpërndarjen e të dhënave);
- ofrimin për qeveritë e vendeve anëtare të mundësisë së përdorimit të menjëhershëm të të dhënave makroekonomike me cilësi të lartë të një vendi, një rajoni apo të krejt botës gjë e cila krijon mundësi për interpretimin e zhvillimeve ekonomike dhe financiare dhe formulimin e politikës brenda një konteksti makroekonomik rajonal dhe global; dhe
- ofrimin për komunitetin ndërkombëtar në tërësi të mundësisë së përdorimit të menjëhershëm të të dhënave makroekonomike të një vendi, të një rajoni apo të krejt botës gjë, e cila krijon mundësi për analiza dhe kërkime.

Për të përmbushur këto detyra, STA ndërmer misione të asistencës teknike, zhvillon kurse dhe seminare për statisticienët e vendeve anëtare pranë FMN në Uashington D.C. dhe në qendra të ndryshme rajonale; merr pjesë në grupin e punës të sekretariatit, që përbëhet nga organizata të ndryshme ndërkombëtare për të përmirësuar metodologjinë duke siguruar në këtë mënyrë vijueshmëri (siç janë Sistemi i Llogarive Kombëtare 1993¹ dhe në fushën e bilancit të pagesave dhe borxhit të jashtëm); për të zhvilluar standardet ndërkombëtare për bilancin e pagesave, statistikën monetare dhe financiare, statistikën fiskale të qeverisë² dhe diskuton rregullisht në takime dypalëshe me vendet anëtare një sërë çështjesh statistikore të këtyre vendeve.

Përveç kësaj, për të kapërcyer mangësitë e faktuara gjatë krizave të fundit financiare, FMN ka përcaktuar një numër nismash për të përmirësuar cilësinë dhe procedurat për shpërndarjen e të dhënave ekonomike dhe financiare në mënyrë të gjthanshme dhe në kohë.

Në fakt, FMN po punon për të siguruar parandalimin e krizave përpara se të shpërthejnë plotësisht. Mjeti më parësor i disponueshëm për parandalimin është mbikëqyrja. Përtej fushave të politikës tradicionale, mbikëqyrja tashmë po përqendrohet në përmirësimin e mjedisit për vendimmarrjen e sektorit privat nëpërmjet masave për të përmirësuar transparencën e politikave të anëtarëve, zhvillimin dhe forcimin e standardeve dhe vlerësimin e reduktimit të paqëndrueshmërisë së anëtarëve ndaj krizave financiare. Këto nisma janë:

- Raporti i Vlerësimit të Standardeve dhe Kodeve (ROSC). Ky raport shqyrton përmbushjen e standardeve të pranuar në shkallë ndërkombëtare ose të kodeve të praktikave më të mira në fusha të ndryshme. Shpërndarja e të dhënave është njëri nga përbërësit e ROSC. Ky përbërës ka të bëjë me çështjet e transparencës duke synuar udhëheqjen e vendeve në procesin e ofrimit të të dhënave për publikun. Këto standarde për të dhënat janë përcaktuar në Sistemin e Përgjithshëm të Shpërndarjes së të Dhënave (GDDS) dhe Standardet e Veçanta të Shpërndarjes së të Dhënave (SDDS)³.
- GDDS ofron një strukturë, që mund të jetë e dobishme për vendet në adoptimin e sistemeve të tyre për të përmbushur kërkesat në evolucionin të komunitetit të përdoruesve. Ai udhëheq vendet anëtare në shpërndarjen tek publiku të të dhënave të besueshme, të plota, në kohë dhe të mundshme për t'u përdorur si dhe i nxit ato të përmirësojnë cilësinë e të dhënave. GDDS është ndërtuar me katër dimensione - tiparet, cilësia, mundësia e përdorimit dhe integriteti i të dhënave. Ai ofron një kuadër

¹ I përgatitur bashkërisht me Komisionin e Komuniteteve Europiane, FMN, Organizatën për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik, Kombet e Bashkuara dhe Bankën Botërore.

² Për shembull, siç publikohet përkatësisht në Manualin e Bilancit të Pagesave, botimi i pestë (BPM5) (1993); Manuali i Statistikave Monetare dhe Financiare (MFSM) (2000); Manuali i Statistikave Financiare të Qeverisë (1986 (GFSM) dhe manuali i ri në përpunim).

³ GDDS do të zbatohet për të gjitha vendet anëtare të FMN, ndërsa SDDS do të zbatohet për ato vende anëtare, që kërkojnë të kenë mundësi hyrjeje në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

për përcaktimin e strategjive të një vendi, identifikimin e prioriteteve dhe objektivat, që janë në përputhje me statistikat reale, financiare, të jashtme, fiskale dhe social - demografike. Hartimi dhe mbikëqyrja e planeve për zhvillim të përgjithshëm kërkon bashkëpunimin e të gjitha agjencive, të cilat luajnë një rol me rëndësi në sistemet statistikore kombëtare, përfshi zyrat statistikore, bankat qendrore, ministritë e financave dhe të tjera institucione, që lidhen me këtë çështje. Për pasojë, përdorimi i GDDS si një kuadër për zhvillimin e sistemit statistikor kombëtar pritet që të ndihmojë vendet pjesëmarrëse në forcimin e bashkëpunimit midis agjencive.

- Kuadri i Vlerësimit të Cilësisë së të Dhënave (DQAF) është një kuadër i ri, i cili është ende në një fazë fillestare zhvillimi dhe synon të përcaktojë anët e dobëta dhe të forta të të dhënave në mënyrë më sistematike, transparente dhe të riprodhueshme me qëllim që të vlerësohet më mirë ndikimi i tyre në analizën e zhvillimeve ekonomike dhe në hartimin e rekomandimeve politike⁴.

Në përfundim, objektivi ynë i përgjithshëm është pasja e sistemeve statistikore të besueshme dhe të plota në vendet anëtare të FMN, të cilat janë në gjendje t'u shërbejnë interesave kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. STATUSI AKTUAL I SISTEMIT STATISTIKOR NË SHQIPËRI

Tani dua të trajtoj gjendjen e sistemit statistikor në Shqipëri.

Përveç vështirësive ekonomike dhe politike të ndryshme, qysh kur Shqipëria iu bashkua FMN-së më 15 tetor, 1991, ka patur zhvillim të spikatshëm në përmirësimin e statistikave makroekonomike e mbështetur nga asistenca e gjerë teknike e agjencive të ndryshme ndërkombëtare.

Në veçanti, FMN ka ndërmarrë në Shqipëri disa misione të asistencës teknike, të cilat kanë trajtuar të gjithë sektorët kryesorë makroekonomikë përgjatë dekadës së fundit, përfshi vendosjen e këshilltarëve rezidentë për statistikat për gjashtë muaj (korrik - dhjetor 1999) për të përmirësuar llogaritë kombëtare.

Janë zbatuar një numër rekomandimesh të FMN (në fushat e bilancit të pagesave, parasë dhe bankave, financave qeveritare dhe indekseve të çmimeve).

3.1 ZHVILLIME POZITIVE

- Në vitin 1996, në Statistikat Financiare Ndërkombëtare të FMN, e njohur gjerësisht si IFS dhe në Librin Vjetor të Statistikave Financiare të Qeverisë, u paraqit faqja e Shqipërisë.
- Zyrtarët e tri agjencive kryesore ofruese të statistikave (Banka e Shqipërisë (BSH), Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Ministria e Financave (MF)) kanë siguruar njohjen e standardeve metodologjike ndërkombëtare dhe i kanë kushtuar përpjekje të konsiderueshme këtyre standardeve, pavarësisht nga burimet e pamjaftueshme.
- Metodologjitë e përpilimit të statistikave të bilancit të pagesave, monetare dhe financiare dhe ato të financave të qeverisë janë, përgjithësisht, në përputhje me metodologjinë e FMN-së.
- Shqipëria është një ndër vendet e para, që ka nënshkruar në GDDS. Nga këndvështrimi i perceptueshmërisë dhe hapjes ndaj përmirësimeve pozitive të autoriteteve në fushën e statistikave, Shqipëria është zgjedhur si vend pilot për Europën Lindore në përgatitjen e një grupi të plotë informacioni mbi sistemin statistikor kombëtar (metadata). Metadata e saj u përdorën si model jo vetëm për Europën, por edhe për shumë vende të tjera.
- Shqipëria është, gjithashtu, një nga vendet e para për të cilat është përgatitur moduli i shpërndarjes së të dhënave të Raportit të Vlerësimit të Standardeve dhe Kodeve (ROSC). Vlerësimi u bë në lidhje me objektivat sasiorë si mbulimi, periodiciteti dhe koha. Në bazë të këtij vlerësimi Shqipëria respekton mjaft mirë specifikimet e GDDS, përveç kuadrit të plotë dhe treguesve për llogaritë kombëtare.
- Është krijuar Këshilli i Statistikave për të formuluar politikën statistikore të Shqipërisë përfshi zhvillimin e programeve dhe përcaktimin e prioriteteve.

⁴ Shpresohet që të nxiten vendet anëtare për të përmirësuar cilësinë e të dhënave zyrtare duke vlerësuar parimet, standardet dhe praktikën e pranuar në shkallë ndërkombëtare për përpilimin dhe shpërndarjen e statistikave makroekonomike. Pesë dimensionet bazë të përcaktuara si dimensione, që kanë ndikim mbi cilësinë dhe integritetin e të dhënave janë vijueshmëria konceptuale, të dhënat burim dhe teknikat statistikore, shërbyeshmëria (sa të shërbejnë të dhënat) dhe disponueshmëria.

- Shqipëria ka rritur theksin për shpërndarjen e statistikave tek përdoruesit. Të gjitha agjencitë kryesore statistikore në Shqipëri, veçanërisht Banka Shqipërisë, INSTAT dhe Ministria e Financave, prodhojnë buletine statistikore periodike dhe të veçanta, të cilat përmbajnë statistika të plota të përpiluara nga këto agjenci. Këto publikime statistikore shpërndahen gjerësisht dhe janë të disponueshme (me ose pa pagesë) për të gjithë përdoruesit e interesuar.

Këto nisma do të mbështesin besimin e komunitetit përdorues, kombëtar dhe ndërkombëtar, tek statistikave zyrtare të Shqipërisë. FMN lavdëron përpjekjet dhe angazhimet e autoriteteve në rritjen e cilësisë dhe të transparencës së të dhënave statistikore. Përveç kësaj, duhet të them që, brenda periudhës prej një viti nga koha kur misioni shumësektorial i FMN-së vizitoi Shqipërinë, autoritetet kanë qenë aktive në zbatimin e disa rekomandimeve të pranuar në planin e veprimeve. Ne dëshirojmë të vazhdojmë bashkëpunimin tonë në zbatimin e masave të mëtejshme për të ndërtuar një sistem statistikor të besueshëm.

3.2 DOBËSITË

Pavarësisht nga ekzistenca e një numri aspektesh pozitive, mbeten dhe një sërë dobësish, të cilat kanë nevojë të trajtohen. Unë do të përqendrohem në më të rëndësishmet. Ato mund të grupohen në dy kategori: (1) mbulimi dhe cilësia; dhe (2) kuadri ligjor dhe institucional.

3.2.1 Mbulimi dhe cilësia

Për të patur statistika makroekonomike të besueshme, duhen bërë vlerësime bazuar në të dhënat e mbledhura nga vërtetimet, të cilat janë të organizuara mirë duke përdorur mostra të përshtatshme, të cilat janë përfaqësuese të popullatës.

Mbulimi i pamjaftueshëm ose të dhëna të marra nga vërtetimet, të cilat kanë normë të ulët përgjigjeje do të ndikojë në cilësinë e të dhënave. Në Shqipëri, burimet e të dhënave bazë, veçanërisht ato që përdoren për sektorin privat dhe në veprimtarinë e tregut jozyrtar si dhe për vlerësimin e transaksioneve joligjore, janë vërtet të pamjaftueshme. Përveç kësaj, vërtetimet statistikore ballafaqohen me probleme të përcaktimit të mostrës dhe të përfaqësimit, dhe procedura të caktuara për vlerësimet kanë nevojë të rishikohen. Këto probleme ndikojnë veçanërisht statistikave të sektorit real dhe të bilancit të pagesave.

Sektori real

- Dobësia më e madhe e sistemit statistikor shqiptar është fusha e llogarive kombëtare. Megjithatë INSTAT ka bërë njëfarë progresi në zhvillimin e një sistemi për të përpiluar të dhënat e PBB-së (sipas kategorive të aktiviteteve dhe shpenzimeve me çmime korente dhe konstante) ende nuk janë të disponueshme të dhënat zyrtare. Vlerësimet paraprake, që janë përgatitur ende nuk janë të publikueshme sepse ato nuk sigurojnë mbulim tërësor të aktivitetit ekonomik, veçanërisht të ekonomisë së nëndheshme. Përveç kësaj, ato vuajnë nga cilësia e dobët e të dhënave burim dhe mungesa e treguesve të përshtatshëm të çmimeve për t'i përdorur si deflatorë të vlerësimeve aktuale për çmimet.
- Pavarësisht se metodologjia për llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) përmbush standardet ndërkombëtare, zërat dhe peshat e shportës kanë nevojë të rishikohen për të pasqyruar situatën sipas Vërtetimit të ri të Buxhetit të Familjarëve, i cili është kryer gjatë periudhës dhjetor 1999-nëntor 2000.
- Cilësia e indeksit të çmimit të prodhimit (PPI) vuan nga mungesa e një mostre, e cila të jetë përfaqësuese e duhur në bazë të së cilës të llogaritet indeksi. Problemi, gjithashtu, buron nga ndryshimet në specifikimet e produktit të përfshira në llogaritjen e PPI.
- Të dhënat për pagat dhe indeksi i prodhimit industrial, gjithashtu, ballafaqohen me mangësi, sepse mbulimi është i kufizuar vetëm në sektorin publik.

Bilanci i pagesave

- Problemet më kryesore lidhen me mbulimin dhe klasifikimin, të cilat janë kryesisht pasojë e burimeve të pamjaftueshme të të dhënave. Në veçanti, sektori privat, përfshi ndërmarrjet e investimit direkt, nuk mbulohet me vërtetimet ekzistuese. Gjithashtu, procedurat e vlerësimit për kontrabandën, transportin dhe sigurimin për importet, flukset hyrëse nga të ardhurat e emigrantëve duhen riparë dhe përditësuar. Po kështu, ka probleme me mbikëqyrjen e borxhit të jashtëm.

3.2.2 Kuadri ligjor dhe institucional

- Është e nevojshme që të forcohet kuadri ligjor dhe institucional për statistikat. Për shembull, baza ligjore për statistikat siç janë ligji “Për statistikat në Republikën e Shqipërisë”, nr. 7687, 16 mars, 1993, dhe ligji i ri “Për Bankën e Shqipërisë” i dhjetorit të vitit 1997, përmbajnë mjaft klauzola të mira dhe që nevojiten për zhvillimin statistikor (siç janë dhënia agjencive statistikore të kompetencave për të mbledhur, analizuar dhe publikuar statistikat në përputhje me standardet ndërkombëtare, si edhe ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave të mbledhura). Megjithëse ligji “Për statistikat” i marsit të vitit 1993 i kërkon INSTAT-it që të mbledhë, të përpunojë dhe të publikojë statistikat, ai është i paqartë në lidhje me një numër fushash të rëndësishme të politikës statistikore. Ai nuk (i) siguron një mandat të qartë për INSTAT-in si agjenci përgjegjëse për përgatitjen e statistikave të llogarive kombëtare; (ii) mbron INSTAT-in nga ndërhyrjet dhe ndikimet e jashtme në lidhje me përmbajtjen dhe me publikimin e statistikave; ose (iii) ofron një mekanizëm të përcaktuar qartë për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikës statistikore në Shqipëri.

Shkurtimisht, dobësitë mund të përmbliidhen në katër fusha kyçe:

- mungesa e të dhënave të llogarive kombëtare të kënaqshme;
- raportim i pamjaftueshëm i veprimtarive të sektorit privat ose jozyrtar;
- nevoja për të përmirësuar procedurat e vrojtimit të ndryshme dhe të vlerësimit;
- kuadër i pamjaftueshëm institucional dhe ligjor për statistikat.

3.2.3 Hapat e ndërmarrë

Autoritetet janë të vetëdijshme për këto probleme dhe po ndjekin një program pune për të trajtuar shqetësimet. Këto dobësi duan kohë për t'u trajtuar dhe kërkojnë burime financiare dhe mbështetje nga sektori privat.

Në veçanti:

- Në lidhje me vlerësimin e PBB-së, FMN ka rekomanduar ndryshime në hartimin e vrojtimit të reja dhe i ka këshilluar autoritetet të krijojnë një kuadër brenda të cilit, të institucionalizohet bashkëpunimi i ofruar ndërmjet agjencive qeveritare për statistikat. Unë jam e kënaqur që mora vesh nga Guvernatori që Banka Botërore po financon një projekt për të bërë një kontroll të përgjithshëm të standardeve të kontabilitetit kombëtar.
- Siç e trajtova më sipër, një problem madhor është mungesa e vrojtimit të mira për llogaritjen e treguesve të çmimit dhe marrja parasyshe e veprimtarisë së sektorit privat. Në këtë përpjekje, INSTAT-i kërkon një asistencë teknike të konsiderueshme si edhe fuqi punëtore shtesë për të dhënë rezultate. Mungesa e burimeve mund të kapërcehet duke përmirësuar shkallën e përgjigjshmërisë të anketave, që u dërgohen njësisë pjesëmarrëse. Punonjësit e INSTAT-it kanë bërë progres të konsiderueshëm në zhvillimin e PPI. Ne jemi të kënaqur kur marrim vesh se INSTAT-i po planifikon të publikojë PPI-në në maj të vitit 2001 bazuar në peshat e reja globale dhe në mostra, që ofrojnë një mbulim më të gjerë me qëllim që të përfaqësohen më mirë sektorët e minierave dhe të prodhimit.
- Të dhënat e bilancit të pagesave mund të përmirësohen duke forcuar burimet ekzistuese të të dhënave, duke kryer vrojtimit dhe duke përmirësuar metodat e vlerësimit. Sektori i Bilancit të Pagesave të Bankës së Shqipërisë ka punuar në trajtimin e këtyre çështjeve. Rekomandimet specifike në këtë fushë përfshijnë: (i) përdorimin e të dhënave nga vendet partnere (veçanërisht Greqia dhe Italia) për të përmirësuar vlerësimet për importet dhe flukset hyrëse të të ardhurave të emigrantëve të regjistruara; (ii) përdorimin e një vrojtimit për shqiptarët, që udhëtojnë jashtë vendit për të vlerësuar shpenzimet e tyre të udhëtimit; (iii) kontrollin e përgjithshëm të sistemit raportues aktual të bankave për ta bërë atë më të plotë nga pikëpamja e mbulimit dhe e klasifikimit të transaksioneve; dhe (iv) rifillimin e vrojtimit për ndërmarrjet e transportit. Ne jemi të kënaqur nga Guvernatori për faktin që po bëhen përpjekje në rrugën e duhur për të rritur numrin dhe cilësinë e vrojtimit, në veçanti, vrojtimin e turizmit.

- Megjithëse agjencitë statistikore i ofrojnë të dhënat nëpërmjet letrave, për të rritur shkallën e përdorimit dhe të dhënies në kohën e duhur të të dhënave për përdoruesit, mund të përdoren mënyra të tjera të shpërndarjes së të dhënave (siç janë emetimi i deklaratave të rregullta për shtyp dhe ofrimi i mundësisë së përdorimit të të dhënave statistikore nëpërmjet kërkesave të regjistruara paraprakisht ose nëpërmjet thirrjeve telefonike të automatizuara, kërkesave me faks, me mënyra elektronike si disketa dhe paraqitjen në internet). Nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë mësuam që ky institucion po punon seriozisht për të parë mundësinë e publikimit të statistikave në internet. Ne e mirëpresim këtë nismë. Përvoja jonë me GDDS dhe SDDS sugjeron që numri i vizitorëve në faqen në internet të FMN-së për këto mjete të shpërndarjes është rritur dukshëm gjatë vitit të kaluar, duke treguar, për pasojë, që ka nevojë dhe interes të konsiderueshëm për të dhëna në komunitetin përdorues.

Në botën tonë me teknologji të përparuar, ofrimi i të dhënave nëpërmjet internetit është një mundësi e dëshirueshme, sepse mjaft banka qendrore apo agjenci statistikore kanë vepruar tashmë në këtë mënyrë. Meqenëse mjetet tona të shpërndarjes ofrojnë lidhje me faqet në internet të këtyre agjencive, nisma për përdorimin e internetit do t'i bëjë të dhënat shqiptare edhe më të përdorshme, jo vetëm për përdoruesit e brendshëm, por edhe për komunitetin ndërkombëtar. Një përparësi e tërthortë e kësaj mundësie është që ajo ndihmon në rritjen e cilësisë me përgjigje të siguruara direkt nga përdoruesit.

4. KONKLUZIONE

Në përfundim mund të them se statistikave makroekonomike të dhëna në kohë, të sakta dhe të plota janë thelbësore për një vend që të mund të ndërmarrë politika të matura. Meqenëse rëndësia e shtetit është duke u pakësuar me pjesëmarrjen në rritje të sektorit privat në Shqipëri, një sistem statistikor i hartuar mirë duhet të marrë parasysh, ashtu siç duhet, veprimtaritë e sektorit privat duke ofruar informacion të mjaftueshëm për të dy sektorët, privat dhe publik, për të formuluar politika dhe për të marrë vendime për investime. Ndërsa Shqipëria ka ndërmarrë hapa në drejtimin e duhur në përpilimin dhe shpërndarjen e të dhënave, një dallim kritik ka të bëjë me veprimtaritë e sektorit privat, veçanërisht të llogarive kombëtare dhe të bilancit të pagesave. Tronditjet e fundit financiare në tregjet botërore vënë theksin në bindjen e sektorëve privatë dhe publikë që ata duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive në veprimtaritë makroekonomike. Takimet, e përfunduara tashmë së fundi, të FMN-së dhe Bankës Botërore në Pragë, gjithashtu, theksuan që një angazhim i tillë do të nxisë angazhimin e sektorit privat në rritjen kombëtare.

Për të patur një sistem statistikor, institucione të ndryshme, përveç përmbushjes së përgjegjësisë të tyre, për të cilat kanë rënë dakort, duhet të punojnë së bashku për të shmangur çdo dublikim të panevojshëm të përpjekjeve. Meqenëse burimet janë të rralla, këto përpjekje të përbashkëta do të sigurojnë, gjithashtu, që çdo agjenci të ndërmarrë pjesë të përgjegjësisë së përgjithshme për të siguruar që përdoren metodologji të sakta (në përputhje me standardet ndërkombëtare) dhe sistemi statistikor përmban të dhëna me cilësi të lartë. Shqipëria ka bërë përparim të dukshëm drejt këtij qëllimi. Ne lavdërojmë pjesëmarrjen e Shqipërisë në GDDS dhe ju inkurajojmë për të ecur edhe më përpara duke zbatuar një numër rekomandimesh, që janë bërë në të kaluarën. Siç e përmenda më sipër, llogaritë kombëtare kanë nevojë të theksohen duke përfshirë përmirësimin e metodologjisë për të llogaritur treguesit e çmimeve. Një prioritet i qartë do të jetë shpërndarja e të dhënave, sa më shpejt që të jetë e mundur, nëpërmjet medias elektronike, veçanërisht nëpërmjet faqeve në internet, sepse kjo do të mbështeste besimin e komunitetit përdorues kombëtar dhe ndërkombëtar të statistikave shqiptare. Ato, gjithashtu, do të sigurojnë drejtimin e zhvillimit makroekonomik tek një numër agjencish vendimmarrëse.

Ndërsa autoritetet po bëjnë atë ç'ka ata munden të bëjnë në kushtet e burimeve të kufizuara, unë i bëj thirrje sektorit privat për të bashkuar forcat për të ndërtuar një sistem të gjithanshëm statistikor. Tashmë dihet që vlerësimet mbi veprimtaritë e sektorit privat nuk janë ato të duhura si për statistikave të llogarive kombëtare ashtu edhe për bilancin e pagesave. Ndërsa, vrojtimet, që përdoren për të vlerësuar këto veprimtari kanë mangësi, duke patur si problem kryesor shkallën e ulët të përgjigjeve nga sektori privat. Ndërtimi i një sistemi statistikor të mirë është një përpjekje e përbashkët e të dy sektorëve, publik dhe privat; dhe do të krijojë një situatë ku "të gjithë janë të fituar".

Ndërsa qeveria do të jetë në gjendje të marrë vendime politike të mira, bazuar në të dhëna më të mira, sektori privat do të përfitojë nga ekonomia në rritje. Besueshmëria e statistikave shqiptare do të përmirësohet dhe vendi mund të nënshkruajë për SDDS duke kaluar kështu në një fazë më të lartë se GDDS. Kjo, për pasojë, do t'i sigurojë vendit për të trokitur në tregjet ndërkombëtare të kapitalit për rritje dhe zhvillim të mëtejshëm. Për pasojë, unë e inkurajoj së tepërmi sektorin privat që të bëjë përpjekje të

tjera në lidhje me nismat e qeverisë. Ju falenderoj për rastin që më dhatë për të shprehur pikëpamjet tona në lidhje me sistemin statistikor në Shqipëri. Ne jemi të kënaqur nga puna me autoritetet në dekadën e kaluar dhe dëshirojmë të vazhdojmë bashkëpunimin në të ardhmen.